




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. 01-01/01-1404 /2024

Datë: 30.01.2024

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 5, 6 pika 1.1, nenit 7, 8 pika 1.1, nenit 14 dhe nenit 15 të Ligjit nr.06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, dhe duke u mbështetur në Rregulloren (QRK)Nr. 09/2022 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale, në mbledhjen e mbajtur me datë 30.01.2024, pas diskutimit lidhur me pikën 6 të rendit të ditës: Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale në parcelën me numër 396/1 Objekti i Qumështores, e miratoi këtë:

V E N D I M

Paraparak për Dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës Komunale

1. Kuvendi i Komunës së Gjakovës miraton vendimin paraparak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale në parcelën me numër 396/1 Zona Kadastrale Brekoc Objekti i Qumështores në pronësi të Komunës së Gjakovës.
2. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme Komunale të cekur në pikën e 1 të këtij Vendimi është në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) viteve.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të Pronës Komunale të cekur në pikën 1 të këtij vendimi është funksionalizimi dhe përfitimi Ekonomik i Komunës nga Pronat Komunale.
4. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër realizohet përmes njoftimit publik në harmoni me nenin 15 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.
5. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është certifikata mbi Pronësinë.
6. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.
7. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës.
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
 - Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë .
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës.
 - Arkivit.



Arbëneshë Kuqi

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Data/nr	22.01.2024 <u>01-463/b1-884</u>
Për:	Arbënesha Kuqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës
CC:	- Të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Gjakovës - Arkivit
Nga:	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës <i>Sedioullw</i>
Lënda:	Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale me numër të parcelës 396/1 - Objekti i Qumështores

Të nderuar,

Duke u bazuar në nenin 58 shkronja (h) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 5, 6 pika 1.1, nenit 8 pika 1.1 dhe 14 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, dispozitave të Statutit të Komunës së Gjakovës të miratuar me datë 28.12.2022, Kryetari i Komunës së Gjakovës me datë 22.01.2024 e parashtroi në Kuvendin e Komunës së Gjakovës këtë:

P R O P O Z I M V E N D I M

1. Kuvendi i Komunës së Gjakovës të miratojë vendimin paraparak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale - me numër të parcelës 396/1 në Zonën Kadastrale Brekoc – Objekti i Qumështores.
2. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme komunale si në piken 1 të këtij vendimi është afatshkurtër, prej pesëmbëdhjetë (15) viteve.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronave është funksionalizimi i pronës dhe përfitimi ekonomik i komunës nga prona komunale.
4. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër realizohet përmes njoftimit publik në harmoni me nenin 15 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.
5. Pjesë përbërëse e këtij Propozim vendimi është:
- Certifikata mbi pronësinë.



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70705008-00396-1

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	10/24
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	22.01.2024 - 10:20
Qomuna / Opština / Municipality:	GJAKOVË / DJAKOVICA / GJAKOVË
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Brekoc / Brekovac / Brekoc
Ëyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	GJAKOVË / DJAKOVICA / GJAKOVË

L. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësive kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësive Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R C/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
P-70705008-00396-1	PARCELË / PARCELA / PARCEL	/ /	Urban	1500	28/09-Ndajje fizike; kërkesa nr. 43/09; dt. 12.08.09		

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
Fusha Vrytes				



2. LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelle Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcelle Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area (m²)
1	Toke Tjetër/Osalo Zemljište/Otherland	Jo Pjellorë/Neplodno/Unproductive		1500

3. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Te drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licen broj ID. No.	Vendbanimi Prebivalište Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësihtë e adresës Pojednostoi adrese Address details	Pjesa e pronës Dio imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
pjesëm individual/ društvena/Drzavina/ ngle possessor	Komuna e Gjakovës	600597986	/ / /		NËNA TEREZË	1/1	21/23-Vendim, 01 nr. 463-02- 3101,dh.09.02.2023,KK Gjakovë	18.05.2023

